



Prishtinë: 10.07.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1176_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1942_05_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **28.06.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin F.I. dhe N.I. nga Podujeva, me shifër të konsumatorit DPR 67128 dhe DPR - 90075150, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1942_05_19** i datës 16.05.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 10.06.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se dy shifrave DPR – 67128 dhe DPR – 90075150 i është vendosur njehsori i përbashkët në shtyllë dhe ku njehsor furnizon dy hapësirat e banimit, dhe se KEDS ka tentuar që të bëjë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe zhvendosjen e njehsorëve për të dy shifrat por që konsumatori nuk ka lejuar që shifrës DPR – 67128 të bëjnë furnizim përmes kabllor ajrore. KESCO ka theksuar se është në dijeni se njehsori në shtyllë bënë matjen e shpenzimit të energjisë elektrike për të dy shifrat DPR – 67128 dhe DPR – 90075150 dhe kjo ka ndodhur për arsye se përderisa është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik te shifra DPR – 90075150 si dhe zhvendosja e njehsorit, tek shifra DPR – 67128 ekipeve të KEDS-it nuk i është lejuar që përmes kabllor ajrore t'i bëhet furnizimi me energji elektrike. KESCO dhe KEDS kanë theksuar se janë për të bërë zgjidhjen sa më optimale dhe se janë të gatshëm për shtrirjen e kabllor ajrore për furnizim të pavarur për të dy shifrat në çdo moment kur lejon konsumatori. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1942_05_19 i datës 16.05.2019 për konsumatorin F.I. dhe N.I. për shifrat DPR – 68128 dhe DPR – 90075150 dhe të kërkojë nga konsumatori që posa të lejoj KEDS-in që përmes zgjidhjes së ofruar nga KEDS të bëjë zhvendosjen e njehsorit të shifrës DPR – 67128 në shtyllë.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se dy shifra DPR – 67128 dhe DPR – 90075150 i është vendosur njehsori i përbashkët në shtyllë dhe ku njehsor furnizon dy hapësirat e banimit, pasi që konsumatori nuk ka lejuar që shifrës DPR – 67128 të bëjnë furnizim përmes kabllor ajrore, Bordi i ZRRE thekson se edhe vendimi i organit të shkallës së parë i ka evidentuar të gjitha procesverbalet, duke filluar nga procesverbalet e inspektimit, procesverbalet e ndërrimit të njehsorit elektrik, procesverbalet e qendrës së kalibrimit dhe se edhe organi i shkallës së parë në ZRRE e ka konstatuar se të dy shifrat DPR – 67128 dhe DPR – 90075150 furnizohen përmes një njehsori i cili është i vendosur në shtyllë. Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, respektivisht procesverbaleve të lartcekura thekson se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 25.01.2018 gjatë inspektimit të pikës matëse të konsumatorit me shifër DPR - 67128 e të regjistruar në emër të F.I. kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar njehsorin nr.69673549 dhe nuk është evidentuar gjendja e shpenzimit, dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.32596193 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh. Bordi ka vërejtur se në procesverbal është theksuar se bëhet zhvendosja e njehsorit elektrik “smart” nr.32596193 jashtë në shtyllë dhe se ky njehsor është për dy shifrat DPR – 67128 dhe DPR – 90075150 dhe se për njehsorin elektrik të vjetër nr.69673549 nuk kemi mundësi të marrim dhe fotografojmë, si dhe njehsori i ri zhvendoset me ndihmën e organeve të policisë. Gjithashtu punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 25.01.2018 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR - 90075150 e të regjistruar në emër të N.I. dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar njehsorin nr.63980925 dhe nuk është evidentuar gjendja e shpenzimit, dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.32596193 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh. Në këtë procesverbal është theksuar se bëhet zhvendosja e njehsorit elektrik “smart” nr.32596193 jashtë në shtyllë dhe se për njehsorin elektrik të vjetër nr.63980925 nuk kemi mundësi të marrim dhe fotografojmë, pasi nuk iu lejohet të hyjnë brenda, si dhe njehsori i ri zhvendoset me ndihmën e organeve të policisë. Duke u bazuar në këtë, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë këtyre dy procesverbaleve ka vërejtur se te konsumatorët me shifër DPR – 67128 dhe DPR – 90075150, KEDS-i i ka montuar njehsorin elektrik “smart” nr.32596193 dhe se ky njehsor elektrik është duke regjistruar energjinë elektrike për të dy shifrat, e kjo sipas KEDS-it pasi që konsumatori nuk ka lejuar hyrjen në objekt punëtorëve të KEDS-it për shtrirjen e kabllor ajrore për furnizim të pavarur të shifrave të lartcekura. Bordi i ZRRE-së konstaton se furnizimi me energji elektrike i dy shifrave me një pikë matëse është në kundërshtim me Rregullat dhe procedurat në fuqi, pasi që secila secili njehsor elektrik duhet të ketë shifrën e vet ashtu që të regjistrojë ndaras energjinë elektrike, si dhe faturimi të bëhet për secilin konsumator ndaras. Bordi i ZRRE-së thekson se kjo pikë e kundërshtimit të KESCO ndaj vendimit të organit të shkallës së parë është e padrejtë pasi që të njëjtin konstatim e ka dhenë edhe organi i shkallës së parë, andaj ky kundërshtim nuk do të duhej të bëhej nga KESCO pasi nuk ka asnjë kontestues në këtë pikë.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar edhe procesverbalet e KEDS nr.0934906 të datës 11.05.2018 nr.0934907 të datës 11.05.2018 bërë për shifrat DPR – 67128 dhe DPR – 90075150 ka vërejtur se edhe gjatë këtyre inspektimeve punëtorët e autorizuar të KEDS-it nuk kanë bërë zhvendosjen e njehsorit elektrik nr.69673549 në shtyllë me qëllim që njehsori elektrik tani më i vendosur në shtyllë nr.32596193 i cili bënë matjen e shpenzimit të energjisë për të dy shifrat të mund të ndahet dhe të bëjë furnizimin vetëm për shifrën DPR – 90071150 dhe jo për shifrën DPR – 67128. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEDS me datë 04.08.2018 kanë dalur te konsumatori dhe kanë ndërrimin e pikës matëse, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.32596193 me gjendja TL=004248 kWh



dhe TU=002004 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.43107384 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=00000 kWh, si dhe kanë theksuar se bëhet ndërrimi i njehsorit me PLC dhe zhvendoset nga brenda në hapësirat jashtë në orman.

Bordi i ZRRE thekson se, në nenin 54 të Ligjit Nr.05/L - 085 për Energjinë Elektrike thuhet se: *“Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”*. Në nenin 53, paragrafi 2 të ligjit të lartcekur, thuhet se: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktojnë tipin, numrin dhe vendin e montimit të pajisjes matëse si dhe kontrollin përkatës dhe mënyrat e komunikimit. Gjatë përcaktimit të vendit të montimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të sigurohen që qasja në njehsor të vihet në dispozicion për qëllime të mirëmbajtjes dhe leximit të pajisjeve matëse”*. Pra pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike sipas dispozitave ligjore të lartcekur janë pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Transmisionit dhe se ata përcaktojnë tipin numrin dhe vendin e montimit. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se në nenin 3.1.1 të Kodit të Matjes thuhet se: *“Pika matëse është pika ku bëhet matja e shkëmbimit të energjisë elektrike në mes të Sistemit të Shpërndarjes, të Sistemit të Transmisionit, Gjeneruesve të pavarur, konsumatorëve dhe përdoruesve tjerë, e vendosur në pikat ndarëse - kufizuese (ose sipas marrëveshjes) të arritura ndërmjet palëve të ndërsjella”*. Neni 3.5.1 i Kodit të Matjes thekson se, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për Operimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemit të Njehsorëve, ku përveç tjerash përfshihet edhe ndërrimi i njehsorëve, e kjo pasi që pika matëse është pronë e Operatorit të Sistemit. Pra, ZRRE potencon qartë se kufiri teknik dhe komercial mes OSSH dhe konsumatorit është pika matëse, pra përgjegjësia e OSSH është deri te pika matëse përfshirë edhe pikën matëse, ndërsa pas pikës matëse përgjegjësi është e konsumatorit.

Sai përket vlerësimit të KESCO-s se janë të interesuar të bëjnë zgjidhjen as më optimale, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në të gjitha shkresat e lëndës si dhe dispozitat ligjore të legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe shkresave tjera që ndërlidhen me furnizimin me energji elektrike të një njehsori për dy shifra, konstaton se faturimi i dyfishtë i bërë nga KESCO për shifrat DPR – 67128 dhe DPR – 90075150 nga periudha e datës 25.01.2018 (kur edhe është vendosur njehsori elektrik nr.32596193 në shtyllë) e tutje duhet të korrigojohet dhe se tani e tutje furnizimi me energji elektrike duhet të jetë ndaras për shifrën DPR – 67128 dhe ndaras për shifrën DPR – 90075150 me njehsor të ndryshëm. Ndërsa sa i përket pikës së ankesës së konsumatorit lidhur me mos shtrirjen e rrjetit elektrik ajror por me shtrirjen e rrjetit kabllor, DMK në ZRRE ju thekson se këtë çështje duhet ta rregulloj konsumatori dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, pasi siç u theksua më lartë kufiri teknik dhe komercial mes OSSH dhe në këtë rast konsumatorit është pika matëse, pra përgjegjësia e OSSH është deri te pika matëse përfshirë edhe pikën matëse, ndërsa pas pikës matëse përgjegjësi është e konsumatorit. Andaj Bordi i ZRRE thekson se vendimi i organit të shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme, madje në asnjë pikë të kundërshtimit të KESCO nuk potencohet se ku është kundërshtimi i KESCO/KEDS ndaj vendimit të organit të shkallës së parë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit F.I. dhe N.I. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.